



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 147 dt. 24.12.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, si dhe bazuar në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e liçensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 24.12.2014, pasi shqyrtoi kërkesën për pajisje me licensë në fushën e restaurimit, për shoqërinë e ndërtimit “FUSHA” shpk, me drejtues teknik Gjerak Karaiskaj, me licensë personale restaurimi R.P. 41,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë së ndërtimit “FUSHA” shpk, me drejtues ligjor z. Shkëlqim Fusha, për pajisje me licensë në fushën e restaurimit për Kategorinë C, “Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës”.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licensë restaurimi, për shoqërinë e ndërtimit “FUSHA” shpk, për Kategorinë C, “Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës” me drejtues teknik Gjerak Karaiskaj.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike, për njoftimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI